Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0851

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj Mexhuani-Kryetare, Isa Hasani-Referues dhe Vedat Poterqoi-Anëtar duke vendosur sipas ankesës së OE Euro-Services shpk, kundër Vendimit për dhënie të një kontrate lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i objektit të FSHMU në Fushticë të Epërme faza II – Komoran Drenas" me numër të prokurimit 214-23-5061-5-1-1, inicuar nga Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoriteti kontraktues (AK), më 06/02/2024, mori këtë:

Vendim

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik "Euro-Services" Sh.P.K. me nr. 2023/851 e datës 30.10.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Ministria e Punëve të Brendshme të datës 11.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i objektit të FSHMU në Fushticë të Epërme faza II - Komoran Drenas" me numër të prokurimit 214-23-5061-5-1-1.

II. Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Ministria e Punëve të Brendshme të datës 11.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

III. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 23.05.2023, Ministria e Punëve të Brendshme duke vepruar në cilësinë e autoritetit kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i objektit të FSHMU në Fushticë të Epërme faza II - Komoran Drenas" me numër prokurimi 214-23-5061-5-1-1, me ç'rast është aplikuar procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, vlera e parashikuar 727,721.07 €.

Me 11.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka publikuar Vendimin përmes të cilit ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik "EBK ShPK & Univers-MI".

Me 16.10.2023, Ankuesi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Vendimin të cituar si më sipër të Autoritetit Kontraktues, e cila është refuzuar si e pa bazuar me vendimin e autoritetit kontraktues të datës 19.10.2023.

Me 30.10.2023, Ankuesi [me të dhëna si më sipër], ka parashtruar ankesën [evidentuar me numër protokolli 2023/0851] në Organin Shqyrtues të Prokurimit, me të cilin ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban elementet e parapara me nenin 111 të LPP dhe është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP, pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sipas nenit 4 paragrafi 1, nën-paragrafi 26 të LPP, kurse ankesa është ushtruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër, e njëjta bije nën kompetencat e këtij Organi përkitazi me shqyrtimin dhe vendosjen në mënyrë meritore, në kuptim të nenit 105 të LPP. Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 01.11.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, i cili me 08.11.2023, e ka dorëzuar pranuar Raportin me rekomandimet:

- ankesa të refuzohet si e pabazuar;
- të mbetet në fuqi vendimi i autoritetit kontraktues;

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli Shqyrtues ka konstatuar paraprakisht se nuk ekzistojnë rrethana për parandalimin e konfliktit të interesit sikurse kërkohet në kuptim të nenit 4 paragrafi 1 nën-paragrafi 75 të LPP, lidhur me nenin 11 të Rregullores për Punën e Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24

paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

Prandaj Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, ka vlerësuar të gjitha provat në dispozicion të shkresave të kësaj lënde dhe ka krijuar bindjen e pavarur të tij se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga ankuesi, së paku lidhur me shkaqet dhe arsyet si në vijim:

Ankuesi ka pohuar se projektet e prezantuara nga OE i rekomanduar nuk janë të përfunduar nga ana e tij/saj, sepse ka qenë vetëm anëtar i konzorciumit, ndërsa OE i cili e ka pasur në ketë projekt statusin e Liderit, nuk është pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit. Paneli Shqyrtues mori në ketë rast në konsideratë, si parim orientues kapacitetet teknike dhe profesionale të parashikuara me dosjen e tenderit [DT] sipas së cilës është kërkuar, cituar: "Operatori Ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses projekte në lëmin e ndërtimit të lartë dhe renovimeve të objekteve të larta..." Kurse në cilësi prove është kërkuar, cituar: "Lista e projekteve të përfunduara..." pa e specifikuar askund nga kuadri i këtij kriteri se, projektet e prezantuara nga OE i rekomanduar domosdo duhet të jenë produkt i punës dhe statusit të tij si lider në ketë apo atë projekt. Kjo d.t.th. se një kufizim i tillë nuk është vendosur në kërkesat e DT dhe krahas këtij fakti, Paneli vëren se në ofertën e të rekomanduarit gjendet lista e projekteve të përfunduara në lëmin përkatëse dhe vlera e tyre të cilat janë në harmoni me kërkesat e DT.

Kurse sa i përket faktit se projektet janë apo nuk janë përfunduar nga tenderuesi i rekomanduar, Paneli Shqyrtues mori parasysh dispozitën e nenit 71, paragrafi 1, të LPP sipas të cilit, cituar: "...Nga asnjëri grup i tillë nuk kërkohet që të marrë përsipër ndonjë formë të veçantë ligjore për të paraqitur tenderin..." Në të vërtetë, pavarësisht kushteve specifike që në ndonjë rast mund ti adresohen në mënyrë specifike liderit të një konzorciumi, megjithatë duhet pasur parasysh faktin se që në kuptim integral të dispozitës së cituar, një Grup i Operatoreve Ekonomik paraqitet me atributet e subjektivitetit juridik e jo nga tiparet specifike të secilit prej tyre. Prandaj kjo zgjidhje ligjore i referohet njëherësh edhe [aktit nënligjor], Rregullave të Prokurimit Publik, në kuptim të nenit 26 paragrafit 26.5, 26.7 dhe 26.8 të kësaj Rregulloreje gjë që edhe nga ana e AK [Komisionit vlerësues] por edhe në Raportin e ekspertit shqyrtues, kriteret e tillë, të atakuar nga pohimet ankimore, janë analizuar dhe/ose vlerësuar në mënyrë të drejtë. Dhe nisur nga kjo pikëpamje Paneli konsideron se pretendimet ankimore si më sipër nuk janë të bazuara, kurse interpretimi i Komisionit Rregullativ të cilit i referohet ankuesi në parashtresën e tij/saj nuk është më në fuqi andaj i njëjti konsiderohet jo-relevant për tu përfshirë në procesin e administrimit të provave, tutje pohimi i ankuesit se paneli duhet të jetë konsistent në raport me nje vendim paraprak, i cili aktualisht eshte ne procedure rivlersimi tek AK sipas udhezimit te panelit shqyrtues, paneli konsideron se konsistenca nuk buron ekskluzivisht nga krahasimi teknik i një vendimi me tjetrin por i referohet vlerësimit objektiv të të gjitha fakteve dhe rrethanave ne raport me secilin aktivitet të prokurimit, përmbajtjen dhe synimin e tij e cila përbën çështje konkrete administrative përkitazi me palët konkrete dhe pretendimet e tyre specifikime të cilat rezultojnë

me një gjykim të pavarur të secilit panel.

Në vijim, ankuesi ka atakuar vendimin e AK dhe lidhur me kapacitetet teknike dhe profesionale, të cilat janë kërkuar për Menaxherin e projektit. Në këtë rast vërehet se në DT, në cilësi të provave janë kërkuar Diploma përkatëse e noterizuar, Biografia/CV, kontrata me punëdhënësin, Vendimi për caktimin e menaxherit të projektit, Referencat për përvojën e punës dhe referenca tjera, pa nevojë që të përshkruhen [përderisa ato figurojnë si të tilla në DT] dhe të gjitha këto pa dilemë se gjenden në ofertën e të rekomanduarit, të cilat nënkuptojnë faktin se i njëjti e ka përmbushur këtë kërkesë në kufijtë optimal. Po ashtu nga shkresat e kësaj lënde konstatohet se nga ky aspekt janë përmbushur kushtet edhe përkitazi dhe me inxhinierët respektivisht stafi tjetër dhe rezulton se pretendimi ankimor është pretendim i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimore kundrejt OE AC Ing SHPK, Paneli vëren se OE AC Ing SHPK është i shpallur i pa suksesshëm për shkak të çmimit më të lartë, megjithëse i njëjti ka dorëzuar listën e kontratave dhe dëshmi përkatëse për kontratat e natyrës së ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit në raport me secilën nga kërkesat specifike të DT. Mirëpo, përderisa i njëjti nuk është palë ankimore në këtë çështje, pohimet ankimore nga ky aspekt konsiderohen jo relevante.

- Përfundim -

Duke ju referuar pohimeve ankimore të prezantuara shkurtimisht si më sipër, shkresave të kësaj lënde dhe administrimit të tyre, krahas hulumtimeve dhe konstatimeve të cilat i përmban raporti i ekspertit shqyrtues, Paneli ka krijuar gjykimin e pavarur të tij se ankesa në rastin konkret nuk mund të konsiderohet e bazuar, kurse vendimi i atakuar i Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 11.10.2023, duke vepruar në cilësinë e autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është në harmoni me parimet bazë të LPP dhe i njëjti mbetet në fuqi.

Andaj mbi këtë bazë konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicioj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- OE - **euro-services shpk**
- Arkivës së OSHP-së: